




Si të flasim rreth Islamit në Evropë?

PRILL 26TH, 2016 OPINIONE ([HTTP://WWW.ISLAMPRESS.INFO/CATEGORY/OPINIONE/](http://www.islampress.info/category/opinione/))

0 KOMENTE ([HTTP://WWW.ISLAMPRESS.INFO/2016/04/26/SI-TE-FLASIM-RRETH-ISLAMIT-NE-EVROPE/#COMMENTS](http://www.islampress.info/2016/04/26/si-te-flasim-rreth-islamit-ne-evrope/#comments))



Akademik Enes Kariq

PËRSE KJO PYETJE?[1]

Vërtetë, përse kjo pyetje nëse dihet se në Evropë sot, veçanërisht në Bashkimin Evropian, liria e fjalës është në piedestale të larta të listës së të drejtave dhe lirive të njeriut? Domethënë, sot në Evropë dhe në Bashkimin Evropian mund të flitet, shkruhet dhe publikohet ajo çfarë duam, çfarë kush donë dhe për atë që donë, edhe për Islamin, nga Islami dhe në emër të Islamit! Për këtë arsye që në fillim është mirë të themi se ne nuk e shkruajmë këtë ese se si të flasim rreth Islamit në Evropë për arsye se atje, si ja, nuk ka liri të fjalës rreth Islamit (prej Islamit, në emër të Islamit) etj. Në të kundërtën, e shkruam për të tërhequr vëmendjen, para së gjithash neve para tjerëve, për atë se përmes kësaj, të themi, lirisë së pafundme e cila shpesh kthehet në një ortek dhe spontanitet, pa ndonjë konsideratat morale, u shfaq (dhe vazhdon) për qindra diskurse mbi Islamin dhe nga Islami, kështu që në këtë kakofoni nuk dihet jo vetëm se “ku cili

mëshon me krye” por nuk mund të mbahet as në mend se sa dhe gjithçka që dikush flet, e për trajtim të veçantë është imazhi i medias rreth Islamit në Evropë dhe fjalimi i numrit të madh të mediave “jomuslimane” rreth Islamit në Evropë! Por, në këtë rast, nuk do të merremi me këtë. Kështu, për shkak të objektivitetit, është e nevojshme të thuhet edhe kjo: Pyetja e parashtruar (“Si të flasim për Islamin në Evropë sot?”) ndan vetëm “të folurit rreth Islamit”, dhe mund të jetë e arsyeshme të thuhet se me pyetjen, në një farë mënyre, “denoncohet” vetëm të folurit rreth Islamit në Evropë (apo të folurit e Islamit në Evropë). E që Islami duke bërë pyetje të tilla nuk stigmatizohet, dhe që të folurit rreth Islamit dhe të folurit e Islamit që më parë nuk dallohet si diçka e veçantë, nëse jo edhe ekzotike, e huaj, e çuditshme, si diçka që këtu nuk i përket dhe nuk i takon, nga çka fitohen fobi dhe fruthe? A nuk do të ishte më mirë që të parashtronim pyetje në lidhje me atë se si janë edhe diskutet tjera rreth religjioneve në Evropë (ose diskutet e religjioneve sot në Evropë në përgjithësi)?

Të gjitha këto pyetje është mirë të parashtrohen, ose të paktën t’i kemi ndër mend, por, këtu ne nuk mund të flasim për të gjitha prej tyre, dhe jo vetëm për shkak të mungesës së hapësirës, por edhe të njohurive. Duke qenë se këtij teksti ne nuk i kushtëzojmë detyrën për t’iu përgjigjur pikërisht të gjithë atyre që mund të paraqiten me rastin e pyetjeve nga titulli i potencuar, është më mirë të kthehemi tek ajo se çka e kemi si prioritet kësaj radhe, pra, rreth të folurit mysliman për Islamin në Evropë sot. Sepse, në fakt, “të folurit mysliman rreth Islamit sot në Evropë” është marrë shpesh, edhe pse pa arsye, si “të folurit e vetë Islamit në Evropë”.

Për këtë arsye, menjëherë të themi se ne në pyetjen: Si të flasim për Islamin në Evropë sot? mendoj në atë se si do të duhej që personalitetet myslimane në Evropë, imamët, hoxhallarët, myftinj, profesorët, rrethet intelektuale me gjurmë islame dhe myslimane, shkrimtarë myslimanë etj., të flasin rreth Islamit në Evropë sot.

POR, CILA EVROPË?

Këtu është i pashmangshëm parashtrimi i disa pyetje në lidhje me atë se çfarë nënkuptojmë kur themi Evropë. Gjeografikisht, me këtë fjalë këtu mendojmë, dhe tregojnë, jo vetëm në Evropën si një kontinent, por në radhë të parë në Bashkimin Evropian, dhe më konkretisht në vendet “thelbësore” të Bashkimit Evropian (Gjermania, Franca etj). Historikisht, megjithatë, për ne (në funksion të kësaj eseje) ajo Evropë (perëndimore) që doli, apo që ekziston për më shumë se gjashtë dekada, nga epoka e saj demokratike, epoka çfarë vazhdoi (dhe vazhdon) që nga fundi i kataklizmit të Luftës së Dytë Botërore, gjegjësisht pas vitit 1945, kur është mundur Evropa fashiste dhe naziste. Ajo është pjesë e globit e cila, që nga viti 1945, ka përjetuar pothuajse bumin më të madh demokratik, kulturor dhe ekonomik. Edhe vetë myslimanët janë gjetur në miliona në këtë pjesë të globit, e të cilët përfituan shumë nga planet e shumta të jetës

evropiane, shumë më vonë u bënë edhe qytetarë të Evropës, qytetarët e saj. Një fenomen i tillë u shënuar në historinë e re të Evropës dhe është e vështirë të gjendet edhe në pjesë të tjera të botës.

Politikisht dhe nga aspekti kulturor, Evropa Perëndimore pas vitit 1945 gradualisht, e më pas në mënyrë intensive, ndërton sistemin e vlerave demokratike dhe laike në shoqëritë e veta. Vendet e Evropës Perëndimore, si mbizotëruese laike, dhe në mënyrën e vet laike, u bënë mbrojtëse e hapësirës publike e cila është me përfshirje të gjerë, e që nuk është armiqësore ndaj feve. Përkundrazi, bashkësitë fetare dhe organizatat fetare kanë shumë partnerë të këtyre vendeve me "shekullarizmin shpirtmirës". Kjo është e rëndësishme kur flasim për Islamin në Evropë sot dhe si myslimanët evropianë duhet të flasin për besimin e tyre në Evropë sot.

Çdokush me aftësi arsyje normale, pse mos të themi dashamirëse, e dinë se myslimanët në miliona gjenden në tokën e Evropës Perëndimore pas vitit 1945. Ata erdhën, pothuajse në numër të madh, nga vendet e Lindjes së Afërt dhe të Mesme, pra, nga ato vende që dikur ishin (dhe jo shumë kohë më parë) koloni evropiane.

Pas gjithë kësaj, kur tregojmë për ata (pak a shumë) njëzet milion myslimanë sot në Bashkimin Evropian, ne të paktën nuk harrojmë se myslimanët në këtë hapësirë të madhe nga viti 1945 e tutje nuk erdhën nga shkaqe fetare (islame), por veçanërisht për arsye dhe shkaqe ekonomike. Kështu që kjo është më se e qartë për shumë njerëz, dhe se secili fjalim rreth islamit në Evropë duhet ta ketë parasysh. Myslimanët pas vitit 1945 në vendet e Evropës Perëndimore nuk erdhën si misionarë të pasur, me planin dhe agjendën e përgatitur për përhapjen e Islamit dhe synimeve propaganduese. Në të kundërtën, myslimanët në Evropën Perëndimore pas vitit 1945 erdhën si popullatë e varfër, si popullatë e varfër e migracionit ekonomik, si gastarbajterë të cilët do të punojnë në mirëmbajtjen e ndërtesave, në hekurudhat, në fabrikat me numrin masiv të punëtorëve fizikë, në hoteleri, në industrinë e automobilave, etj. Me kalimin e kohës, shumë kanë fituar edhe vende tjera pune më të mira (të paguara). Por, edhe pse myslimanët në Evropën Perëndimore pas vitit 1945 erdhën si emigrantë ekonomik, si fuqi punëtore e lirë për ekonominë evropiane në bum-in e pasluftës, duhet të kihet parasysh fakti, e që është më i rëndësishëm në lidhje me ardhjen e myslimanëve në Evropën Perëndimore, dhe, më pas, në Bashkimin Evropian, se klima demokratike në Evropën Perëndimore, dhe, më vonë, gjithë përfshirja e Bashkimit Evropian, ka lejuar ardhjen dhe zhvillimin e mëvonshëm të ekzistencës së këtyre tani njëzet milion myslimanëve në Evropë?! Sigurisht që kjo duhet të kihet parasysh, dhe secili diskurs serioz mysliman rreth Islamit në Bashkimin Evropian duhet ta ketë parasysh pikërisht llojin e saj të demokracisë.

Evropa Perëndimore dhe, më pas, Bashkimi Evropian, ishte një mundësi për emigruesit ekonomik mysliman jo vetëm të fitojnë një punë, dhe kështu të fitojnë mirë, por edhe që pasardhësit e tyre të edukohen, shkollohen, përparojnë. Prandaj, kush nga myslimanët dëshiroi, ai pati mundësi që ta kultivojë edhe identitetin e vetë fetar. Një numër i madh i tyre këtë e dëshiroi, kështu që, së shpejti, migrimi ekonomik mysliman në Bashkimin Evropian u njoh si një segment i veçantë fetar; kështu që tani njihet në miliona, si një emigracion fetare (islam apo mysliman).

Pasojat e myslimanëve, të brengës së punëtorëve për fenë e tyre islame në Evropën Perëndimore, janë shumë të dukshme për tre ose katër dekada: Sot në Evropën Perëndimore (por edhe në të gjithë Bashkimin Evropian) ka mijëra qendra islame, komunitete, xhami (dhjetëra prej tyre janë me minare), ka shumë biblioteka islame apo myslimane, shoqëritë, shoqatat, gazetatat, portalet, shtëpitë botuese, etj. Dikush do të thotë: Epo, mirë, që ka një numër të konsiderueshëm të myslimanëve në Evropën Perëndimore (dhe në BE-në) është diçka – normale! Dhe se ka kaq shumë prej institucioneve islame apo “fetare”, forume, komunitete, etj., ne, nga ana jonë, shtojmë: A është sot ekzistenca e komuniteteve myslimane të diasporës (por edhe të familjarizuar) në Bashkimin Evropian pasojë e hapjes së tij, d.m.th. sistemeve demokratike evropiane ose, nga ana tjetër, një pasojë nga diçka tjetër? Mendimi ynë është ai që i anon qëndrimin se emigrimi ekonomik mysliman në numër të tillë nuk do të mund të rrënjëzohej në Evropë dhe, më pas, gjatë viteve, të njihet si një popullsi fetare, dhe pastaj të krijojë institucionet e veta fetare dhe kulturore, po të mos kishte themele demokratike mbi të cilat bazohet Evropa moderne perëndimore. Pikërisht respekti për themelet demokratike mbi të cilat bazohet Evropa Perëndimore sot, do të duhej të gjenden në një fjalim rreth Islamit sot në këtë pjesë të botës. Dhe jo për shkak të zhvillimit të çfarëdo qëndrimi përbuzës ndaj Evropës Perëndimore tek myslimanët, por për arsye se diskursi mysliman mbi Islamin në këtë pjesë të Evropës të fitojë besueshmërinë, modernizmin e vetë, realizmin e vetë.

CILI FJALIM RRETH ISLAMIT NË EVROPË?

Për fat të keq, që ne sot në Evropën Perëndimore (dhe në gjithë Bashkimin Evropian) kemi shpeshherë “fjalime të shfrenuara” për Islamin (jo vetëm nga “mediat jo-myslimane”, por edhe nga vetë myslimanët) është vetëm një nga pasojat tragjike të mungesës së një elite të fortë myslimane në Bashkimin Evropian sot. Nga kjo elitë, po të kishte më shumë, do të pritej që për Islamin të flitet në gjuhën e opinionit publik evropian dhe të medias e standardeve të komunikimit sot: TV kanaleve me reputacion dhe radios, portaleve të internetit, filmave, programeve arsimore, numrit shumë më të madh të gazetave moderne të profilizuara, revistave, gazetave dhe shtypit në përgjithësi etj. E gjithë kjo, natyrisht, në një nga gjuhët evropiane: anglisht, frëngjisht, gjermanisht etj.

Megjithatë, me keqardhje të madhe, diskursi i sotëm myslimanë rreth Islamit në Evropë, kryesisht i projektuar ose i formuluar në atmosferën e fjalimeve nga minberëve të xhamive, është ende i caktuar me vendet e origjinës së emigrimit ekonomik të myslimanëve, që si fuqi punëtore, me stomak për bukë, vinte nga Afrika e Veriut, Lindja e Mesme, Turqia, Ballkani ... ky emigracion në Evropë me vete solli shprehje të shumëfishta “popullore”, pjesërisht edhe “fisnore” të islamit, me përcaktues rural. (Nëse pyetemi këtu vetëm kalimthi, e që është vendi i duhur për një pyetje të tillë: Për çfarë “zgjedh” Kurani? Për jetesë rurale apo fisnore të Islamit? Ose, për kultivimin e jetesës islame urbane dhe kulturore? Përgjigjja është më së miri të kërkohet në vetë Kuranin. Të përkujtojmë, surja 49:14 e tutje, ka mënyrën e qartë, dhe, ashtu të themi, shumë të fuqishme të distancës ndaj islamit “fisnor” ose “beduin”. Ky, si dhe vende të tjera në Kuran, e të cilët prekin në këtë çështje, ndajnë besime universale dhe themelore të Islamit (imanit) dhe, në një farë mënyre, i vënë në mbrojtje kundër sulmit (dhe pushtimit!) të entuziazmit fisnor, përleshjes, fanatizmit, mbinxehjes malore.

Por sot, pikërisht nga një numër i madh minberësh dhe predikimeve të xhumasë në gjithë Evropën, duke përfshirë edhe atë perëndimore, ne shohim, dëgjojmë dhe, nëse kemi durim, dëgjojmë të folurit e myslimanëve për Islamin me plotë fanatizëm, dhe me thjeshtësi malësore... Për më tepër, ligjërimi i sotëm mysliman mbi Islamin në Evropë shpesh reduktohet në universin e tërë të gruas në Islam – në shumë tribuna dhe minbere evropiane (më të përhapura për meshkuj!) – silltet vetëm në “pyetjet rreth hixhabit dhe nikabit”! Askush, natyrisht, nuk duhet të sjell në pyetje as të drejtën, as lirinë e hixhabit. Le të ketë hixhab në rrugët e Evropës. Por, mënyra rigide me të cilën flitet nga goja e myslimanëve në Evropë duhet të jetë subjekt i kritikave serioze, kritikave tona myslimane...!

Në harresën e vetë ose injorimit të qëllimshëm që për Islamin në Evropën Perëndimore kryesisht të flasin për një besim të devotshëm në Zotin e dashur, si burim i pashtershëm i vetëdijes morale dhe rezonimit, shumë prej propagandistëve myslimanë të “Islamit të vërtetë” në Evropë paturpësisht dalin kundër programeve sociale të projektuara jashtëzakonisht mirë (dhe, çka është më e rëndësishmja, të zbatuara!) në shoqëritë e pasura në vende/shtete të Evropës Perëndimore. Të përkujtojmë: Janë të shpeshta tribuna të propagandistëve myslimanë në gjithë Evropën Perëndimore për superioritetin e “mësimeve sociale të Islamit” mbi zbatimin e parimeve të mbrojtjes sociale çfarë i realizon Evropa Perëndimore përbrenda institucioneve të saja të rregulluara laike. Ndërkohë që ligjëruesit dhe propaganduesit mysliman (të cilët edhe vetë me bollëk harxhojnë para të mëdha nga këto fonde sociale evropiane!) rrallë pyeten se çfarë është e dobishme nga grumbullimi në yjet “të mësimeve të përsosura sociale të Islamit” – të vështruara me dyli të kthyer kah librat me qëndrime të vjetra nga “periudha e artë e islamit” e hershme – kur dihet se mësime të sotme sociale të Islamit aplikohen në mënyrë efektive me mezi në njëzet vende dhe shoqëri myslimane!

TË AFIRMOHET I FOLURI RRETH ISLAMIT SI BESIM NË ZOT, SI MORAL, SI MIRËSJELLJE, SI KULTUR DHE QYTETËRIM

Në vend të mohimit të procedurave demokratike të vendeve të Bashkimit Evropian, predikuesit dhe ligjëruesit mysliman do të ishte më mirë t'i parashtronë pyetje vetvetes: Si është e mundur që, për dekada të tëra, në një Gjermani laike të mbahen zgjedhjet ndërsa nga pasionet politike, partiake apo fetare askush, bash askush, nuk vritet në rrugët e Munihut, Hamburgut, Berlinit ...?!

Në vend të mohimit të programeve të rregulluara laike, predikuesit dhe ligjëruesit mysliman do të ishte më mirë të pyesin veten se ku do të dëshironin të gëzonin pensionin: Në një Gjermanin laike apo në Egjiptin mysliman?! Në Francën laike apo në Libinë myslimane?!

Këtu do të ishte lista e gjatë e pyetjeve që do të duhej t'ia parashtronë vetës predikuesit dhe ligjëruesit myslimanë në Evropë. Në gjithë këtë përkujtojmë vetëm për një arsye: Që të folurit myslimanë rreth Islamit në Evropë të kthjellat nga e kaluara, të zgjohet në të sotmen, që me obligim serioz të merret parasysh arritja e Evropës Perëndimore në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut, kujdesit të pafuqishmëve, të dobëtëve, të marginalizuarve etj., etj.

Fjalimi alternativë rreth Islamit (në të cilin Islami konfrontohet me Evropën e sotme laike e liberale dhe demokracisë së saj) është ai i folur rreth Islamit që thekson mësimet e veta fetare dhe morale, arritjet e veta kulturore dhe civilizuese (në të cilat me të drejtë, dhe krenari, duhet të kujtohem). Ndërkohë që, vetvetiu, do të zhvillohej një koncept i të sotmes, pra, evropianizimit bashkëkohor dhe modern i islamit. Për evropianizimin e Islamit kemi disa shembuj të mëdhenj të së kaluarës, por nuk do të flasim rreth kësaj tani. Kur këmbëngulim për evropianizimin e Islamit, nuk bëhet fjalë këtu për "balsamin" e Islamit për nevojat e përkohshme evropiane. Përkundrazi, bëhet fjalë për arritjen e atyre interpretimeve autentike të Islamit të cilat janë gjithëpërfshirëse, të cilat nuk janë rigide, që nuk provokojnë fërkimin dhe shkëndijën e kulturave dhe qytetërimeve. Nga pikëpamja e parimeve të veta të besimit (pra akaidit) Islami është një dhe i njëjtë kudo, por, nga pikëpamja e arritjeve të kulturave dhe qytetërimeve, Islami është treguar si i veçantë, me dhunti të shumta, i mrekullueshëm. Islami përgjatë pesëmbëdhjetë shekujve të tij realizohet në numër të madh të zonave dhe nën zonave kulturore, gjuhësore, civilizuese dhe klimatike.

Pikërisht për shkak se asnjë religjion në Evropë sot nuk i është ekspozuar armiqësisë së përditshme të mediave siç është rasti me Islamin (e në gjithë këtë, është fatkeqësi e veçantë edhe në atë se në gjithë Evropën llogotitjet rreth islamit për më shumë se një dekadë i përforcojnë edhe vetë myslimanët), këtu duam të nxjerrim disa këshilla se në

cilat drejtime dhe fusha duhet të përqendrohen kreatorët e diskursit myslimanë rreth Islamit në Bashkimin Evropian dhe në Evropë në përgjithësi, veçanërisht në rripin e saj mediteran.

Së pari – evropianizimi i Islamit sot është i nevojshëm përmes medias të formësohet me gjuhën e autoriteteve myslimane të cilat ka kohë që janë përkthyer (e që edhe sot ende përkthehen) në gjuhët evropiane: Ibn Sina (Avicena), Al-Ghazaliu, Ibn Rushdi (Averoes), Abduhu, Iqbali etj.

Së dyti – është i nevojshëm trajtimi i islamit për nga kultura dhe qytetërimi me gjuhën dhe diskursin sikur që bënë miqtë myslimanë nga Evropa: Goethe, pastaj Annemarie Schimmel, Katharina Mommsen, Hans Küng, Tim Winter dhe shumë Evropianë dhe Evropiane të tjerë të rinj. Sot ka me qindra prej tyre si dhe veprat e tyre pothuajse në të gjitha gjuhët e Evropës.

Së treti – është e nevojshme që formuluesit e diskursit në komunitete myslimane të Bashkimit Evropian të kenë njohuri dhe ndjenjat në lidhje me ato se cilat janë aspekte të pakalueshme të Islamit, (parimet fetare, p.sh.) dhe ato që janë, përsëri, thjesht të përkohshme dhe të rastit (kalifatet, sulltanatet, emiratet). Dhe realizimet e dikurshme historike të Islamit (p.sh. kalifatet) kurrë nuk duhet të marrin statusin, e as vendin, ose pjesën integrale të besimit islam.

Së katërti – diskursit të duhur mbi Islamin në Evropë më së shumti do t'i kontribuonte edukimi bashkëkohor teologjik islam, programet e të cilit do të jenë bërë në kontekstin evropian. Për fat të keq, pak ka prej myslimanëve të pasur sot (edhe pse ka shumë miliardë myslimanë!) të cilët janë të gatshëm për të hapur disa universitete islame në disa qytete të mëdha evropiane. E gjithë çfarë kemi sot në Bashkimin Evropian u krijua me mund të madh dhe iniciativat entuziaste.

Në fund të kësaj eseje të themi se Islami sot është shpesh dhe në shumë mënyra (në Bashkimin Evropian, në Evropë dhe më gjerë) një temë e thjeshtë e sigurisë, dhe kështu në përgjithësi dhe trajtohet.

Në myslimanët Evropianë, në myslimanët e Evropës, shtrohet një detyrë që Islami mëson jo me temën e fesë, (por të) kulturës dhe qytetërimit. Nëse në këtë arrijnë, ndoshta bota e mediteranit, si dhe bota e hemisferës perëndimore mund të fillojë të quhet kultura dhe qytetërimi judeo-krishterë-myslimanë. Ndoshta!

Përktheu nga boshnjakishtja:

Mr. sc. Azmir Jusufi

[1] Nga faqja e internetit: <http://cdv.ba/kolumne/enes-karic-kako-o-islamu-govoriti-u-evropi-danas/> (<http://cdv.ba/kolumne/enes-karic-kako-o-islamu-govoriti-u-evropi-danas/>)

(Islampress)

Empfehlen 52 Personen empfehlen das. Empfehl dies deinen Freunden.

Shperndaje:  (<https://twitter.com/intent/tweet?text=Si+t%C3%AB+flasim+rreth+Islamit+n%C3%AB+Evrop%C3%AB%3F&url=http%3A%2F%2Fte-flasim-rreth-islamit-ne-evrope%2F>)  (<http://www.facebook.com/sharer.php?u=http%3A%2F%2Fwww.islampress.info%2F2016%2F04%2F26%2Fsi-te-flasim-rreth-islamit-ne-evrope%2F>)  (<http://plus.google.com/share?url=http://www.islampress.info/2016/04/26/si-te-flasim-rreth-islamit-ne-evrope/>)

ARTIKUJ TË NGJASHËM



OPINIONE ([HTTP://WWW.ISLAMPRESS.INFO/CATEGORY/OPINIONE/](http://www.islampress.info/category/opinione/))

(<http://www.islampress.info/2016/05/05/pendimi-tevbe-nje-mundes-i-per-rimekembje-te-muslimanit/>)

MAJ 5TH, 2016

Pendimi (tevbe) një mundësi për rimëkëmbje të muslimanit (<http://www.islampress.info/2016/05/05/pendimi-tevbe-nje-mundes-i-per-rimekembje-te-muslimanit/>)

OPINIONE ([HTTP://WWW.ISLAMPRESS.INFO/CATEGORY/OPINIONE/](http://www.islampress.info/category/opinione/))



(<http://www.islampress.info/2016/05/03/multimedhhezimi-mes-konfliktit-dhe-mirekuptimit/>)

MAJ 3RD, 2016

Multimedhhezimi, mes konfliktit dhe mirëkuptimit

(<http://www.islampress.info/2016/05/03/multimedhhezimi-mes-konfliktit-dhe-mirekuptimit/>)

OPINIONE ([HTTP://WWW.ISLAMPRESS.INFO/CATEGORY/OPINIONE/](http://www.islampress.info/category/opinione/))



(<http://www.islampress.info/2016/05/02/shen-gjergji-jurjeva/>)

MAJ 2ND, 2016

Shën Gjergji (Jurjeva) (<http://www.islampress.info/2016/05/02/shen-gjergji-jurjeva/>)



OPINIONE ([HTTP://WWW.ISLAMPRESS.INFO/CATEGORY/OPINIONE/](http://www.islampress.info/category/opinione/))

(<http://www.islampress.info/2016/05/02/dialog-per-shkak-te-besimeve/>)

MAJ 2ND, 2016

Dialog për shkak të besimeve... (<http://www.islampress.info/2016/05/02/dialog-per-shkak-te-besimeve/>)




OPINIONE ([HTTP://WWW.ISLAMPRESS.INFO/CATEGORY/OPINIONE/](http://www.islampress.info/category/opinione/))

(<http://www.islampress.info/2016/05/01/ne-boten-e-urtensive-te-sejjid-ahmed-rifaiut/>)

MAJ 1ST, 2016

Në botën e urtësive të Sejjid Ahmed Rifaiut... (<http://www.islampress.info/2016/05/01/ne-boten-e-urtensive-te-sejjid-ahmed-rifaiut/>)

OPINIONE ([HTTP://WWW.ISLAMPRESS.INFO/CATEGORY/OPINIONE/](http://www.islampress.info/category/opinione/))



(<http://www.islampress.info/2016/04/27/rendesia-e-llogaridhenies-se-brendshme-per-muslimanet/>)

PRILL 27TH, 2016

Rëndësia e llogaridhënies së brendshme për muslimanët (<http://www.islampress.info/2016/04/27/rendesia-e-llogaridhenies-se-brendshme-per-muslimanet/>)

KOMENTO

Emri:

Email:

Website:

Komenti:

Shkruaj komentin



Islam Press

Like Page

7.4K likes



Islam Press shared a link.

57 mins



Pendimi (tevbe) një mun...

Sipas botëkuptimit islam mëkat do të t...

ISLAMPRESS.INFO

10

Comment

Share

UA REKOMANDUJMË



A lejohet të falet namazi i xhenazes dy herë?

([http://www.islampress.info/2014/12/28/a-](http://www.islampress.info/2014/12/28/a-lejohet-te-falet-namazi-i-xhenazes-dy-hera/)

[lejohet-te-falet-namazi-](http://www.islampress.info/2014/12/28/a-lejohet-te-falet-namazi-i-xhenazes-dy-hera/)

[i-xhenazes-dy-hera/](http://www.islampress.info/2014/12/28/a-lejohet-te-falet-namazi-i-xhenazes-dy-hera/))

([http://www.islampress.info/2014/12/28/a-](http://www.islampress.info/2014/12/28/a-lejohet-te-falet-namazi-i-xhenazes-dy-hera/)

[lejohet-te-falet-namazi-i-xhenazes-dy-hera/](http://www.islampress.info/2014/12/28/a-lejohet-te-falet-namazi-i-xhenazes-dy-hera/))



([http://www.islampress.info/2015/01/08/permbajuni-](http://www.islampress.info/2015/01/08/permbajuni-xhematit-porosia-e-pejgamberit-a-s-per-kohen-tone/)

[xhematit-](http://www.islampress.info/2015/01/08/permbajuni-xhematit-porosia-e-pejgamberit-a-s-per-kohen-tone/)

[porosia-e-](http://www.islampress.info/2015/01/08/permbajuni-xhematit-porosia-e-pejgamberit-a-s-per-kohen-tone/)

[pejgamberit-](http://www.islampress.info/2015/01/08/permbajuni-xhematit-porosia-e-pejgamberit-a-s-per-kohen-tone/)

[a-s-per-](http://www.islampress.info/2015/01/08/permbajuni-xhematit-porosia-e-pejgamberit-a-s-per-kohen-tone/)

[kohen-tone/](http://www.islampress.info/2015/01/08/permbajuni-xhematit-porosia-e-pejgamberit-a-s-per-kohen-tone/))

'Përmbajuni xhematit' -
Porosia e Pejgamberit

a.s. për kohën tonë
(<http://www.islampspress.info/2015/01/08/permbajuni-xhematit-porosit-a-s-per-pejgamberit-a-s-per-kohen-tone/>)

8 Janar, 2015



(<http://www.islampspress.info/2015/01/02/muhammedi-a-s-sinteze-unikale-e-vlerave/>)

**Muhammedi a.s.,
 sintezë unike e vlerave**
(<http://www.islampspress.info/2015/01/02/muhammedi-a-s-sinteze-unikale-e-vlerave/>)

2 Janar, 2015



(<http://www.islampspress.info/2015/01/15/vlerat-ne-te-cilat-ka-thirrur-pejgamberi-i-fundit/>)

**Vlerat në të cilat ka
 thirrur Pejgamberi i
 fundit, Muhammedi a.s.**
(<http://www.islampspress.info/2015/01/15/vlerat-ne-te-cilat-ka-thirrur-pejgamberi-i-fundit/>)

15 Janar, 2015



(<http://www.islampspress.info/2014/12/26/jakubi-a-s-dhe-ndikimi-i-stresit-psikik-ne-humbjen-e-shikimit/>)

**Jakubi a.s. dhe ndikimi i
 stresit psikik në
 humbjen e shikimit**
(<http://www.islampspress.info/2014/12/26/jakubi-a-s-dhe-ndikimi-i-stresit-psikik-ne-humbjen-e-shikimit/>)

26 Dhjetor, 2014



Dispozita e sheriatit për atë që nuk e fal namazin

(<http://www.islammepress.info/2015/01/26/dispozita-e-sheriatit-per-ate-qe-nuk-e-fal-namazin/>)

(<http://www.islammepress.info/2015/01/26/dispozita-e-sheriatit-per-ate-qe-nuk-e-fal-namazin/>)



(<http://www.islammepress.info/2015/09/13/pushimi-mjektor-per-te-shkuar-ne-haxh/>)

Pushimi mjektor për të shkuar në haxh


(<http://www.islammepress.info/2015/09/13/pushimi-mjektor-per-te-shkuar-ne-haxh/>)

13 Shtator, 2015

TË FUNDIT

-
- 5 MAJ 13:08 **SHËRBIME ()**
Qendra ndërfitare krijon ura midis besimeve në Elbasan
 (<http://www.islammepress.info/2016/05/05/qendra-nderfetare-krijon-ura-midis-besimeve-ne-elbasan/>)
 - 5 MAJ 13:00 **OPINIONE ()**
Pendimi (tevbe) një mundësi për rimëkëmbje të muslimanit
 (<http://www.islammepress.info/2016/05/05/pendimi-tevbe-nje-mundesesi-per-rimekembje-te-muslimanit/>)
 - 5 MAJ 10:53 **NGJARJE ()**
Muftiu i Asadit: Perandoria Osmane nuk ka qenë Islame
 (<http://www.islammepress.info/2016/05/05/muftiu-i-asadit-perandoria-osmane-nuk-ka-qene-islame/>)
 - 5 MAJ 10:34 **ISLAMISTIKE ()**
Njeriu, kjo qenie e përkryer! (<http://www.islammepress.info/2016/05/05/njeriu-kjo-qenie-e-perkryer/>)
 - 5 MAJ 10:13 **NGJARJE ()**
Gjyshja shqiptare mbush 114 vjet, dëshiron të shkoj edhe njëherë në haxh
 (<http://www.islammepress.info/2016/05/05/gjyshja-shqiptare-mbush-114-vjet-deshiron-te-shkoj-edhe-njehere-ne-haxh/>)
 - 5 MAJ 10:01 **NGJARJE ()**
AKP do të mbajë kongres: Davutogllu nuk pritet të kandidojë
 (<http://www.islammepress.info/2016/05/05/akp-do-te-mbaje-kongres-davutogllu-nuk-pritet-te-kandidoje/>)

- 4 MAJ 17:33 **NGJARJE ()**
Itali: Vjedhja e ushqimit nuk është krim! (<http://www.islammepress.info/2016/05/04/itali-vjedhja-e-ushqimit-nuk-eshte-krim/>)
- 4 MAJ 17:06 **ISLAMISTIKE ()**
Kurani është çelësi për çdo dry (<http://www.islammepress.info/2016/05/04/kurani-eshte-celesi-per-cdo-dry/>)
- 4 MAJ 17:04 **NGJARJE ()**
Merkel: Nuk më pëlqejnë deklaratat se “muslimanët nuk mund të hyjnë në vendin tonë” (<http://www.islammepress.info/2016/05/04/merkel-nuk-me-pelqejne-deklaratat-se-muslimanet-nuk-mund-te-hyjne-ne-vendin-tone/>)
- 4 MAJ 17:01 **NGJARJE ()**
Për herë të parë nuk kishte namaz të xhumasë në Halep (<http://www.islammepress.info/2016/05/04/per-here-te-pare-nuk-kishte-namaz-te-xhumase-ne-halep/>)



Islampress.info

... i saktë dhe autokton

(<http://www.islammepress.info>)

Duke u nisur nga parimi: më shumë gjuhë fetare, se sa fjalë mbi fenë, “Islam Press” nisi rrugëtimin e davetit (thirrjes), rrugëtim i cili manifeston një traditë shumë të gjerë dhe të lashtë, gjerësia e së cilës përfshinë katër anët e globit, e gjatësia gjurmën e davetit mbarë pejgamberik. Islam Press mëton të ruaj autenticitetin e fesë dhe interpretimin autokton të saj.

REGJISTROHU

Që postimet t'i merrni në e-mailin tuaj

IMPRESSUM

Tel: +41 76 346 56 12

Email:

info@islammepress.info

marketing@islampress.info

Botues:

Islam Press Media

© **Islam Press** 2014. Të gjithë të drejtat e mbrojtura.
Prodhues: **Islam Press Media**